

# **Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël, Tremujori I 2019**

**Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël****a. Deklarata e përputhshmërisë**

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e Raportimit dhe Përmbajtjen e Raportimit Financiar” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) e aprovuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. MRF është aprovuar për qëllime rregullatore, në përputhje me Nenin 47 të Ligjit Nr 9662, të datës 18 dhjetor 2006 “Mbi Bankat në Republikën e Shqipërisë” (“Ligji Bankar”).

**b. Bazat e përgatitjes**

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek Shqiptar rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, nëse nuk shprehet ndryshe dhe janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

**c. Konvertimi në monedhë të huaj**

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar me kursin e këmbimit valutor të datës kur është kryer transaksioni. Aktivët dhe pasivët monetarë të shprehura në monedha të huaja në datën e bilancit, janë konvertuar në monedhën matëse me kursin e këmbimit të asaj dite. Diferencat që rrjedhin nga këmbimet valutore regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kapitali aksionar është trajtuar si një zë monetar dhe rivlerësohet në përputhje me politikën e sipërpërmendur. Sipas kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë kapitali në monedhë të huaj duhet të kontabilizohet në bilanc me kursin e ditës kur është kryer transaksioni dhe një zë “Rezervë Rivlerësimi” krijohet në grupin e kapitalit dhe përfaqëson diferencën midis kursit fiksis të Bankës së Shqipërisë të fundvitit me kursin historik me të cilin është regjistruar kapitali në monedhë të huaj.

Normat e aplikueshme të këmbimit (lekë për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 Mars 2019 dhe 31 Dhjetor 2018 ishin si vijon:

	<b>31 Mars 2019</b>	<b>31 Dhjetor 2018</b>
USD	111.67	107.82
EUR	125.34	132.42

**d. Arka dhe Llogaritë me Bankën Qëndrore**

Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjëndje të pakushtëzuara me bankat qendrore, të cilat ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra. Arka dhe llogaritë me Bankën Qendrore mbahen me koston e amortizuar në bilancin e konsoliduar.

*Arka dhe mjete monetare të ngjashme*

Arka dhe mjetet monetare të ngjashme përfshijnë gjendjen e arkës, balancat me Bankën Qendrore (përveç rezervës së detyrueshme) si dhe balancat me bankat dhe institucionet e tjera financiare me maturim fillestar tre muaj ose më pak.

#### **e. Aktivet Financiare**

Aktivitetet financiare njihen kur Banka bëhet palë kontraktuale në transaksion. Aktivitetet financiare njihen fillimisht dhe më pas mbarten në kosto. Kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje në momentin që ato ndodhin. Të ardhurat nga interesi përlogariten në normë nominale dhe njihen në fitim ose humbje kur ato përfitohen. Çdo zbritje nga blerja ose primi amortizohet / përlogaritet deri në datën e shlyerjes. Humbjet që rezultojnë nga zhvlerësimi i këtyre investimeve njihen në fitim ose humbje si "Humbje nga zhvlerësimi i investimeve financiare", në periudhën kur ato kryhen.

Aktivitetet financiare përfshijnë huatë dhe paradhëniet për klientët, të drejtat ndaj bankave dhe institucioneve financiare, investimet në bono thesari dhe obligacione, investimet në pjesë të kapitalit dhe të arkëtueshme të tjera.

#### **f. Investime në letra me vlerë**

Investime në letra me vlerë klasifikohen në dy kategori: letra me vlerë të investimit të vlefshme për shitje dhe të mbajtura deri në maturim bazuar në qëllimin dhe aftësinë e Bankës për t'i mbajtur ato deri në maturim.

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim janë ato investime të cilat mbartin pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe kanë maturitete fikse dhe të cilat Banka ka synimin dhe aftësinë t'i mbajë deri në maturim dhe të cilat nuk i përmbushin kushtet për tu klasifikuar si hua apo llogari të arkëtueshme. Nëse Banka do të shesë një shumë të pa konsiderueshme të letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim, atëherë e gjithë kategoria do të riklasifikohet si letra me vlerë të vlefshme për shitje

#### **g. Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjallta të riblerjes**

Letrat me vlerë të shitura nën marrëveshje për riblerje në një datë të ardhshme të caktuar ("REPO-t") nuk ç'regjistrohen nga bilanci. Mjetet monetare korresponduese të marra, duke përfshirë interesin e përlogaritur, njihen në bilanc si "Detyrime ndaj Bankave", duke reflektuar thelbin ekonomik si një hua të dhënë Bankës. Diferenca midis çmimit të shitjes dhe riblerjes trajtohet si shpenzim interesi dhe maturohet gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes duke përdorur metodën e interesit efektiv. Anasjelltas, letra me vlerë të blera nën marrëveshje për rishitje në një datë të ardhshme të caktuar ("REPO-t e anasjellta") regjistrohen si hua ndaj bankave apo hua dhe paradhënie klientëve, si të jetë më e përshtatshme. Mjetet monetare të paguara, duke përfshirë interesin e përlogaritur, njihen në bilanc si "Hua nga Bankat". Diferenca midis çmimit të blerjes dhe atij të rishitjes trajtohet si e ardhur nga interesi dhe maturohet gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes.

#### **h. Hua dhe paradhënie për klientët**

Huatë dhe paradhëniet për klientët përfshijnë kreditë me afat të përcaktuar, overdraftet dhe produktet e lidhura të kredisë dhënë nga Banka, si pjesë e aktivitetit të saj normal të biznesit. Kreditë dhe paradhëniet për klientët njihen me vlerën e tyre nominale zvogëluar me pagesat e kreditit të mbledhura nga konsumatorët. Të ardhurat nga interesi përlllogariten mbi balancat e papaguara të kredisë me normën nominale. Çdo tarifë e disbursuar e mbledhur para disbursimit njihet si e ardhur e shtyrë dhe ndahet në fitim ose humbje në baza lineare përgjatë afatit të kredisë.

Politika huadhënëse e Bankës është në përputhje me ligjet në fuqi (Ligji për Bankat dhe Rregullorja e Bankës së Shqipërisë “Për Administrimin e Rrezikut të Kredisë” miratuar me Vendimin Nr. 52, datë 14 korrik 2004, ndryshuar me Vendimin Nr.101, datë 27 dhjetor 2006, ndryshuar me Vendimin Nr. 31, datë 30 prill 2009, ndryshuar me Vendimin Nr. 59 dhe Nr. 61, datë 29 gusht 2008, ndryshuar me Vendimin Nr. 47, datë 10 qershor 2009, ndryshuar me Vendimin Nr. 62 datë 14 shtator 2011, ndryshuar me Vendimin Nr. 27, datë 27 mars 2013, ndryshuar me Vendimin Nr. 22, datë 27 shkurt 2014, ndryshuar me Vendimin Nr. 26, datë 1 prill 2015 dhe ndryshuar me Vendimin Nr. 50, datë 30 mars 2016 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë). Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë huatë e klientëve kreditit në gjashtë kategori të rrezikut. Për çdo kategori të rrezikut, duhet të zbatohen normat e mëposhtme minimale të provigjionimit:

<b>Klasifikimi</b>	<b>Vonesat për Overdraftet</b>	<b>Vonesat për kreditë me afat</b>	<b>Normat e provigjionimit</b>
Aktuale	0 ditë	0 ditë	1%
Standarde	1-30 ditë	1-30 ditë	1%
Në ndjekje	31-60 ditë	31-90 ditë	5%
Nën standarde	61-90 ditë	91-180 ditë	20%
Të dyshimta	91-180 ditë	181-365 ditë	50%
Të humbura	Mbi 180 ditë	Mbi 365 ditë	100%

Kreditë dhe paradhëniet për klientët raportohen neto nga provigjionet për humbjet specifike të kredisë për kreditë e klasifikuara si nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Provigjionet e krijuara për humbjet e mundshme në kredi të klasifikuara si standarde dhe në ndjekje janë të klasifikuara si provigjione statistikore në pasiv të bilancit.

Në përputhje me udhëzimin e Bankës Qendrore, Banka llogarit dhe njeh në fitim dhe humbje interesin për kreditë dhe paradhëniet e klasifikuara si aktuale, standarde dhe në ndjekje. Kur huatë dhe paradhëniet ndryshojnë klasifikim, duke u klasifikuar si Nënstandarde, Banka ndalon së njohuri interesin e përlllogarit në fitim ose humbje. Interesi i huave, që klasifikohen në tre klasat e fundit të klasifikimit përlllogaritet jashtë Bilancit dhe njihen (riklasifikohen) në fitim ose humbje kur mblidhet

#### **Politikat e fshirjes së kredive**

Banka fshin një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga rënia në vlerë) kur Komiteti i Kredive Problematike të Bankës vendos që huatë/letrat me vlerë janë të paarkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhja e ngjarjeve të konsiderueshme, të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

Në çdo rast banka fshin kreditë nga bilanci, jo më vonë se tre vite pas klasifikimit të tyre në klasën “të humbura”. Gjatë kësaj periudhe, banka merr masat e nevojshme për plotësimin e kushteve të përcaktuara në legjislacionin tatimor për fshirjen e kredive nga bilanci.

Përjashtim nga kërkesa e mësipërme bëjnë:

a) kreditë, për të cilat në vendimmarrjen e vetë bankës dhe vetëm pas miratimit të Bankës së Shqipërisë, argumentohet se mbështetur në analizën gjendjes financiare të kredimarrësit dhe në cilësinë e kolateralit, vërtetohet mundësia efektive e shlyerjes/ripagimit të saj; dhe

b) kreditë në proces ristrukturimi, për të cilat në çdo rast, përjashtimi nga kërkesat e këtij neni, nuk mund të tejkalohet një periudhë 6 mujore që nga dita që kredia ka plotësuar kushtet për t’u fshirë.

Dosjet e kredive të fshira nga bilanci, ruhen dhe vlerësohen në vazhdimësi, duke u shqyrtuar jo më pak se një herë në 6 (gjashtë) muaj nga Këshilli Drejtues i bankës. Banka, pavarësisht fshirjes së kredive nga bilanci, vazhdon të ndjekë procedurat ligjore për arkëtimin e këtyre kredive.

#### **i. Aktivet afatgjata jomateriale**

Aktivitet afatgjata jomateriale mbahen fillimisht me kosto minus amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar. Aktivitet afatgjata jomateriale përfaqësojnë programin kompjuterik, i cili amortizohet duke përdorur metodën e amortizimit linear mbi kohën e parashikuar të shfrytëzimit prej katër vjetësh. Amortizimi llogaritet duke filluar nga muaji në vijim të muajit të blerjes.

#### **j. Aktivet afatgjata materiale**

Aktivitet afatgjata materiale mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare me qëllim shpërndarjen e kostos së aktiveve afatgjata mbi kohën e parashikuar të shfrytëzimit.

Përqindjet e përdorura të amortizimit vjetor janë si më poshtë:

	<b>Norma vjetore</b>
Ndërtesat	5%
Makineri dhe Pajisje	20%
Pajisje Kompjuterike dh elektronike	25%
Mobilje dhe Orendi	20%

Amortizimi llogaritet duke filluar nga muaji në vijim të muajit të blerjes.

Rikonstruktionet e ambienteve të marra me qira mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare mbi kohën e parashikuar të shfrytëzimit të ambienteve të marra me qira.

#### **k. Pronate e rimarra në zotërim**

Në disa rrethana të caktuara, pronat e vëna në hipotekë mund të rimerren në zotërim pas heqjes të së drejtës mbi hipotekën e huave të këqija. Pronat e rimarra në zotërim vlerësohen me më të voglën midis vlerës së ankandit të fundit dhe vlerës së drejtë, pasi i janë zbritur kostot e shitjeve, të njohura në pasqyrat financiare individuale si “Aktive të tjera”. Qëllimi i Drejtimit ndaj pronave të rimarra në zotërim është shitja sa më e shpejtë e tyre, duke i përdorur të ardhurat nga shitja për uljen e borxheve të këqija

#### **I. Detyrimet financiare**

Detyrimet financiare njihen kur Banka bëhet palë kontraktuale në transaksion. Detyrimet financiare njihen dhe mbarten me kosto. Kostot e transaksionit njihen në fitim ose humbje kur ato ndodhin. Shpenzimet e interesit njehsohen me normë nominale dhe njihen në fitim ose humbje kur llogariten. Detyrimet financiare përfshijnë detyrimet ndaj bankave dhe institucioneve financiare dhe detyrimet ndaj klientëve.

Detyrimet ndaj klientëve shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlllogaritjeje.

Detyrimet ndaj institucioneve financiare shprehen në shumën e mbetur të principalit. Interesi është kontabilizuar mbi bazë përlllogaritjeje.

#### **m. Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen në fitim ose humbje kur ato janë të fituara ose të llogaritura, përveç të ardhurës nga interesi i kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve të klasifikuara si nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura, e cila është përlllogaritur jashtë bilancit dhe njihet në fitim ose humbje në periudhën kur është ajo është arkëtuar dhe jo kur është fituar.

Çdo prim ose zbritje që rezulton si diferencë midis çmimit të blerjes së investimeve dhe vlerës nominale amortizohet në fitim ose humbje në mënyrë lineare derisa investimi të maturohet.

#### **n. Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet**

Të ardhurat nga komisionet për llogaritë rrjedhëse, çeqet, transfertat e parave dhe transaksionet e tjera bankare regjistrohen si të ardhura kur arkëtohen. Komisionet për huatë shtyhen në kohë dhe njihen gjatë jetës së huasë. Shpenzimet e komisionit regjistrohen kur shpenzimet janë paguar.

#### **o. Përfitimet e punonjësve dhe kontributet për pensione**

Banka kontribuon në planet e pas pensionimit të punonjësve të saj siç përshkruhet nga legjislacioni i brendshëm i sigurimeve shoqërore. Banka operon sipas një plani të përcaktuar për pensionet. Banka paguan kontributet për punonjësit e saj, në institucionin e zotëruar nga shteti (ISSH), mbi baza mujore dhe në mënyrë të detyrueshme. Pasi kontributet janë paguar, Banka nuk ka detyrime të mëtejshme për të paguar. Kontributet përbëjnë kosto neto periodike për vitin në të cilin ato duhet të paguhet dhe si të tilla janë të përfshira në zërin "Shpenzime personeli" në pasqyrën e të ardhurave.

#### **p. Provigjone**

Provigjonet për çështjet gjyqësore regjistrohen kur Banka ka një detyrim aktual ligjor ose që rrjedh nga praktika e mëhershme si rezultat i ngjarjeve të mëparshme; ka më shumë mundësi që të ketë dalje të burimeve në mënyrë që të mbyllet detyrimi; dhe kur vlera e detyrimit është vlerësuar në mënyrë të besueshme.

**q. Tatimi mbi fitimin**

Banka e përcakton tatimin në fund të vitit në përputhje me legjislacionin tatimor shqiptar. Norma e tatimit mbi fitimin është 15% (2017: 15%) mbi të fitimin e tatueshëm.

Tatim fitimi i pagueshëm llogaritet duke rregulluar fitimin statutor përpara taksave (sipas pasqyrave të përgatitura në përputhje me SNRF) për disa zëra të caktuar të të ardhurave dhe të shpenzimeve siç kërkohet nga legjislacioni shqiptar. Siç shprehet në ligjin dhe rregulloren për tatimin, në përcaktimin e fitimit të tatueshëm Banka mund të zbresë pjesën e mbajtur për zhvlerësim të përcaktuar sipas Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

**r. Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara**

Gjatë rrjedhës normale të biznesit, Banka hyn në angazhime të lidhura me kredinë, të cilat regjistrohen tek angazhime dhe detyrime të pritshme dhe përfshijnë kryesisht garancitë, letër kreditë dhe angazhimet e papërfunduara të huasë. Angazhime të tilla financiare regjistrohen jashtë bilancit dhe njihen në bilancin e Bankës nëse dhe kur ato bëhen të pagueshme.

**s. Informacioni krahasues**

Informacioni krahasues është paraqitur në mënyrë të vazhdueshme në zbatimin e politikave kontabël të Bankës, kur shifrat e nevojshme krahasuese janë paraqitur për të arritur krahasueshmërinë.